

MENDIM PAKICE

1. Unë, anëtare/relatore e trupit gjykues Etleda Çiftja, nuk isha dakord me shumicën e trupit gjykues dhe, për pasojë, votova kundër konfirmimit në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Petrit Vukaj. Në vlerësimin tim, subjekti i rivlerësimit nuk duhet të ishte konfirmuar në detyrë. Në vijim shtjellohet arsyetimi, mbi të cilin mbështetet qëndrimi im.

Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

2. Unë si anëtare në pakicë, lidhur me mungesën e burimeve të ligjshme në shumën (-) 1.459.774 lekë të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, që lidhet me blerjen e pasurive në momentin e krijimit të tyre, si dhe me kryerjen e shpenzimeve, vlerësoj se e vetme kjo mungesë nuk mund të përbëjë shkak për shkarkimin e subjektit sipas pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, por ndryshe nga përfundimi i arritur nga shumica e trupit gjykues, vlerësoj se kjo shumë e pajustificuar me burime të ligjshme, duhet të merret në konsideratë në vlerësimin tërësor për të tria kriteret e procesit të rivlerësimit, për të cilat unë kam vlerësuar ndryshe nga shumica e trupit gjykues, sipas parashikimit të pikës 4 të nenit 2 të ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me kriterin e vlerësimit të figurës

3. Ligji nr. 84/2016, në nenin 34 parashikon se: *“Objekt i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin e atyre subjekteve që kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës”* dhe në nenin 3, pika 15¹, parashikon se person i përfshirë në krimin e organizuar është çdo person që është dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10192/2009, me përjashtim të rastit kur është deklaruar i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë.

4. Ligji nr. 10192/2009, në pikën 1 të nenit 3², ka përcaktuar se dispozitat e tij zbatohen për pasuritë e personave, që zotërohen plotësisht ose pjesërisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, mbi të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në *indicie*, për: *“a) pjesëmarrje dhe kryerje të krimeve nga banda e armatosur, organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal, të parashikuara nga kreu XI i Kodit Penal...”*.

5. Nga hetimi administrativ rezulton se subjekti në vitin 2014 ka përdorur për të shkuar me familjen në ***, Greqi, automjetin tip “Mercedes-Benz” me targë ***, pronë e shtetasit S. M.. Për vërtetimin e deklaramentit të tij ka paraqitur deklaratën noteriale nr. ***, datë 8.1.2021, të shtetasit S. M. M. dhe kontratën e përdorimit të mjetit nr. ***, datë 30.4.2014. Gjithashtu, rezulton se në datën 15.4.2021 shtetasi S. M. është arrestuar nga shërbimet e policisë me qëllim ekstradimi drejt Italisë, për shkak se ishte në kërkim ndërkombëtar, pasi ishte dënuar me 7 vite e 6 muaj burg nga autoritetet gjyqësore të *** në Itali për veprat penale “Grup kriminal”,

¹ Ligji nr. 84/2016, neni 3: *“15. Person i përfshirë në krimin e organizuar” është çdo person që është dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar, me përjashtim të rastit kur është deklaruar i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë. Personi konsiderohet i përfshirë në krimin e organizuar edhe kur: a) procedimi penal i filluar ndaj tij pushohet nga organi procedues për shkak të vdekjes, ose sepse nuk mund të merret si i pandehur dhe nuk mund të dënohet; b) deklarohet i pafajshëm nga gjykata pasi vepra penale është kryer nga një person, që nuk mund të akuzohet ose dënohet”*.

² Ligji nr. 10192/2009, neni 3: *“1. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për pasuritë e personave, që zotërohen plotësisht ose pjesërisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, siç përcaktohet në pikën 2 të këtij neni, mbi të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në indicie, për: “a) pjesëmarrje dhe kryerje të krimeve nga banda e armatosur, organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal, të parashikuara nga kreu XI i Kodit Penal...”*”.

“Shfrytëzim prostitucioni” dhe “Plagosje”. Në kushtet kur vepra penale “Grup kriminal” sipas legjislacionit italian konkurron me veprën penale “Grup i strukturuar kriminal”, që parashikohet në nenin 333/a, kreu XI i Kodit Penal Shqiptar, bazuar në pikën 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, shtetasi S. M. konsiderohet “person i përfshirë në krimin e organizuar”.

6. Në rezultatet e hetimit kryesisht, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit për konstatimet se: (i) *Duket se kontakti i subjektit të rivlerësimit me shtetasin S. M. nëpërmjet përdorimit të automjetit në vitin 2014, dhe më tej lëshimi i deklaratës noteriale në vitin 2021, është kontakt i papërshtatshëm faktik i subjektit me “person të përfshirë në krimin e organizuar”, sipas parashikimit të pikës 6 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016;* (ii) *Duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar pranimin e favorit të përdorimit të pasurisë/automjet nga shtetasi S. M. në formularin e deklaramit të figurës sipas parashikimeve të shtojcës 3, pjesa 5, germa “e” e ligjit nr. 84/2016, pasi kësaj pyetjeje i është përgjigjur “jo”, në kushtet kur ky shtetas sipas parashikimeve të pikës 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016 konsiderohet “person i përfshirë në krimin e organizuar”, pasi është dënuar për një nga veprat e parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10192/2009, i ndryshuar.*

7. Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti është shprehur se ekzistencën e një procedimi penal ndaj shtetasit S. M. në shtetin italian e ka mësuar për herë të parë pasi u njoh me rezultatet e hetimit në datën 14.5.2024. Më tej, deklaroi se këtë shtetas për herë të parë e ka rastisur në vitin 2014, pasi ishte njohje e mikut të tij, shtetasit O. M.. Në atë periudhë, sqaron subjekti, do të udhëtonte familjarisht drejt shtetit grek për të shkuar tek kunati i tij dhe i ka kërkuar shtetasit O. M. të përdorë automjetin e tij për vetëm 3 ditë udhëtimi. Duke qenë se ky shtetas nuk mund t’ia vinte në dispozicion automjetin e tij për arsye personale, vijon subjekti, i ka siguruar automjetin e mikut të tij, S. M.. Në vijim shpjegon se nuk e njihnte këtë person dhe nuk ka njohje të drejtpërdrejtë përveçse në vitet 2014 dhe 2021, kur për efekt të procesit të rivlerësimit i ka kërkuar të lëshojë një deklaratë noteriale për të konfirmuar dhënien e automjetit për përdorim për vetëm 4 ditë. Për vërtetimin e deklaramit, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale të shtetasit O. M., lëshuar në datën 27.5.2024, i cili konfirmon deklaramin e tij.

8. Më pas shpjegon se ndaj këtij shtetasi ka nisur procedimi penal për ekstradim për llogari të një vendimi gjyqësor italian të vitit 2002, vetëm në vitin 2021, ndërkohë që plotësimi dhe dorëzimi i deklaratës *Vetting* nga ana e tij është bërë në janar të vitit 2017, 4 vite më përpara regjistrimit të procedimit, fakt të cilin nuk kishte si ta dinte dhe kërkon që Komisioni duhet ta trajtojë kontaktin me shtetasin S. M. si një kontakt rastësor. Gjithashtu, në seancën gjyqësore të datës 10.6.2024 subjekti, përveç shpjegimeve të mësipërme, deklaroi se nuk ka pasur dijeni për arrestimin e shtetasit S. M. në prill të vitit 2021, pasi në periudhën 16.3.2021 – 30.3.2021 ka qenë i sëmurë me Covid dhe ka qenë i vetizoluara. Për vërtetimin e deklaramit, subjekti ka paraqitur në seancë kopje të vërtetimit nr. *** regjistri, datë 16.3.2021, të Qendrës Shëndetësore nr. ***, Fier.

9. Lidhur me faktet dhe rrethanat e administruara nga hetimi kryesisht, nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me rrethanat rënduese apo lehtësuese që merren parasysh në konstatimin se ekziston një kontakt i papërshtatshëm në raport me deklaramet e subjektit të rivlerësimit, vlerësoj se:

9.1 *Së pari*, për sa i përket deklaramit se “*Është njohur lidhur me procedimin penal të shtetasit S. M. nga rezultatet e hetimit*”, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar në mënyrë të besueshme, duke marrë në konsideratë rrethanat si vijon: (i) arrestimi i shtetasit S. M. është publikuar nga të gjitha mediat në nivel kombëtar; (ii) arrestimi i këtij shtetasi është bërë nga

Drejtoria Vendore e Policisë së Qarkut Fier; (iii) ndjekja e procedurave për ekstradimin e këtij shtetasi është bërë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, ku subjekti ushtron funksionin. Për më tepër, duke pasur në vëmendje edhe rrethana të tjera si: (iv) natyrën e detyrës që ushtron subjekti i rivlerësimit; (v) faktin që pak kohë përpara se të arrestohej³ shtetasi S. M., subjekti i ka marrë deklaratën noteriale të datës 8.1.2021, për përdorimin e automjetit të tij në vitin 2014; (vi) Fieri është qytet me përmasa gjeografike të vogla me popullsi pothuajse homogjene; (vii) sikurse ka deklaruar subjekti, shtetasi i mësipërm ushtron aktivitetin e shitjes së karburantit në qytet, aktivitet që ushtrohet nga pak subjekte tregtare – vlerësoj se deklarimi i subjektit se është njohur lidhur me procedimin penal të shtetasit S. M. nga rezultatet e hetimit të dërguara nga Komisioni, është i pabesueshëm, i vlerësuar me rrethanat e parashikuara sipas pikë 4 të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016.

9.2 Së dyti, subjekti ka deklaruar në seancën dëgjimore të datës 10.6.2024 se *nuk ka pasur dijeni për arrestimin e shtetasit S. M., pasi ka qenë i sëmurë me Covid dhe ka qenë i vetizoluar*, ndërkohë që sipas vërtetimit të datës 16.3.2021 të Qendrës Shëndetësore nr. ***, Fier, të paraqitur nga subjekti në seancë, rezulton se subjekti ka qenë i sëmurë me Covid në periudhën 16.3.2021 – 30.3.2021 dhe jo në datën 15.4.2021, kur është bërë arrestimi i këtij shtetasi nga shërbimet e policisë. Për pasojë, vlerësoj se deklarimi i subjektit se nuk ka pasur dijeni për arrestimin e shtetasit S. M., pasi ka qenë i sëmurë me Covid dhe ka qenë i vetizoluar, nuk është i mbështetur në provat shkresore të depozituara nga vetë subjekti dhe, e vlerësuar kjo me rrethanat e parashikuara sipas pikës 4 të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, ky deklarim i subjektit, përveçse është i paprovuar, është edhe i pabesueshëm.

9.3 Së fundi, lidhur me deklarimin e subjektit se *e njeh shtetasin S. M. nëpërmjet shtetasit O. M. dhe Komisioni duhet ta trajtojë kontaktin me shtetasin S. M. si një kontakt rastësor*, nga hetimi rezulton se në përgjigje të pyetësorit standard⁴ subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. ***, datë 8.1.2021, të shtetasit S. M., i cili ka deklaruar se: *“Unë kam njohje me shtetasin Petrit Vukaj dhe në vitin 2014 Petriti më thotë se do të shkonte në Greqi tek kunati i tij, për tre net, bashkë me familjen e tij, me mjetin e tij tip “Mercedes-Benz”... Unë i thashë merr mjetin tim... kurse unë do mbaja mjetin e Petritit...”*. Bashkë me deklaratën e mësipërme subjekti ka paraqitur kontratën noteriale të përdorimit të mjetit nr. ***, datë 30.4.2014, në të cilën pasqyrohet se shtetasi S. M. i ka dhënë në përdorim automjetin subjektit për periudhën 30.4.2014 – 30.4.2015. Sa më sipër, fakti që shtetasi S. M. në deklaratën noteriale të datës 8.1.2021 ka deklaruar se ka njohje me shtetasin Petrit Vukaj (dhe nuk përmend faktin se e njeh nëpërmjet shtetasit O. M.), bashkë me faktin që i ka dhënë në përdorim automjetin e tij për një periudhë 1-vjeçare, **tregojnë se subjekti ka njohje personale me shtetasin S. M. dhe kjo njohje nuk është rastësore**. Për pasojë, vlerësoj se deklarimi i subjektit se nuk ka njohje me shtetasin S. M., kjo është njohje e mikut të tij O. M. dhe kontakti me këtë shtetas është rastësor, është i pabesueshëm.

9.4 Në përfundim, vlerësoj se deklarimi i subjektit se është njohur për procedimin penal të shtetasit S. M. vetëm nga rezultatet e hetimit, e më pas përpjekja e tij për ta kanalizuar kontaktin si njohje jo e drejtpërdrejtë e tij por e mikut të tij O. M. dhe si kontakt rastësor, **përbën në thelb një përpjekje të subjektit të rivlerësimit për të fshehur marrëdhënien me këtë shtetas, në kuptim të nenit DH, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës**.

³ Arrestimi është bërë në datën 15.4.2021.

⁴ Email datë 27.1.2021; të paraqitura dhe fizikisht në Komision, protokolluar me nr. *** prot., datë 28.1.2021.

9.5 Megjithatë, në vlerësim të konkluzioneve të mësipërme për kriterin e figurës, unë si anëtar në pakicë çmoj se problematikat e adresuara më lart në lidhje me kriterin e figurës nuk janë të mjaftueshme për vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit në raport me kontrollin e këtij kriteri, sipas parashikimit të nenit 61, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, çmoj se këto problematika të pasqyruar më lart duhet të merret në konsideratë në një vlerësim të përgjithshëm për të tria kriteret e procesit të rivlerësimit që është kryer ndaj subjektit, sipas parashikimit të pikës 4 të nenit 2 të ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

10. Lidhur me dosjen nr. 5, që i përket procedimit penal nr. *** të vitit 2015, për veprën penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, për të cilin subjektit iu kërkuan shpjegime për konstatimin se: (i) *Subjekti i rivlerësimit nuk ka urdhëruar kryerjen e aktit të ekspertimit autoteknik të motomjetit të sekuestruar për të përcaktuar karakteristika e tij lidhur me fuqinë motorike; (ii) Subjekti ka marrë në përgjegjësi penale të pandehurin për veprën penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, në kushtet kur fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale; (iii) Subjekti ka marrë në përgjegjësi penale shtetasin J. Xh., duke mos zbatuar parimin e ligjshmërisë të parashikuar nga neni 2 i Kodit Penal, vlerësoj se subjekti nuk ka paraqitur shpjegime bindëse që përmbysin rezultatin e hetimit, pasi:*

11. Neni 291⁵ i Kodit Penal është një dispozitë blankete dhe për zbatimin e tij kërkohet referimi në Kodin Rrugor dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Një nga elementet e anës objektive të kryerjes së veprës penale të sipërcituar është drejtimi i automjeteve apo mjeteve të tjera të motorizuara pa dëshminë përkatëse. Në kohën kur është arrestuar i dyshuari në fuqi ishte ligji nr. 175/2014, “Për disa ndryshime në Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë”⁶. Ky ligj në shtesat dhe ndryshimet që i ka bërë neneve të Kodit Rrugor, përkatësisht nenit 115, pika 3, parashikon se: “...në kategorinë A1 futen motomjetet deri në 125 cc dhe me fuqi 11 KË”. Më tej, në nenin 123⁷, pika 2, në shkronjat “dh” dhe “ë” parashikon se leja e drejtimit e dhënë për kategorinë B është e vlefshme për kategoritë A1, nëse është mbi moshën 21 vjeç.

12. Nga hetimi ka rezultuar se shtetasi J. Xh. është i pajisur me leje drejtimi automjeti të kategorisë B dhe në kohën kur është ndaluar ka qenë 32 vjeç (mbi 21 vjeç). Në vijim të ndjekjes logjike të hetimeve nuk rezulton që subjekti të ketë urdhëruar kryerjen e aktit të ekspertimit autoteknik për të përcaktuar karakteristika e motomjetit. Ndërkohë që akti i ekspertimit autoteknik të motomjetit të sekuestruar është bërë gjatë gjykimit të çështjes nga gjykata dhe ka rezultuar se motomjeti i të pandehurit është me fuqi motorike 110 cc, duke mos plotësuar elementin e anës objektive të veprës penale të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal. Sa më sipër, si pasojë e moskryerje së veprimeve të nevojshme hetimore, subjekti ka marrë në përgjegjësi penale shtetasin J. Xh., në kushtet kur fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, duke cenuar parimin e ligjshmërisë të parashikuar nga neni 2 i Kodit Penal.

13. Në përfundim, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht

⁵ Kodi Penal, neni 291: “Drejtimi i automjeteve apo mjeteve të tjera të motorizuara në gjendje të dehur, nën efektin e lëndëve narkotike apo pa dëshminë përkatëse të aftësisë dënohet me burgim nga dhjetë ditë deri në tre vjet”.

⁶ Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 203, datë 31.12.2014.

⁷ Ligji nr. 175/2014, neni 123: “2. Vlefshmëria e lejedrejtimit të mjetit sipas kategorive është si më poshtë: ... dh) Lejedrejtimi e dhënë për kategoritë A, B, C ose D është e vlefshme përkatësisht për kategoritë A1 e A2, B1, C1 ose D1...; ë) Lejedrejtimi e kategorisë B është e vlefshme në territorin kombëtar për të drejtuar mjete rrugore me tri rrota, me fuqi më të madhe se 15 KË, si dhe motomjetet e kategorisë A1, me kusht që mbajtësi i lejedrejtimit të jetë, të paktën, 21 vjeç”.

hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin, kritere të parashikuara në pikën 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.

Të dhëna nga burimet arkivore të KLP-së dhe Prokurorisë së Përgjithshme

14. Lidhur me procedimin penal nr. *, datë 1.4.2015**, të regjistruar për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290, paragrafi 3 i Kodit Penal, për të cilin Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit për konstatimin se: (i) *Subjekti në dokumentin “Diskutim përfundimtar” drejtuar gjykatës ka kërkuar pezullimin e ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim të pandehurit, duke u bazuar vetëm në rrethanat që lidhen kryesisht me të pandehurin, pa marrë në konsideratë rrethanat e kryerjes së veprës penale si: (1) shkallën e pakujdesisë së autorit të saj, nga ku rezulton se aksidenti ka ardhur për shkak se drejtuesi i mjetit ka lëvizur me shpejtësi 161.6 km/orë, nga 80 km/orë që ka qenë shpejtësia e lejuar në atë segment rrugor; (2) pasojën shoqërisht të rrezikshme, vdekjen e shtetasit P. B.;* (ii) *Subjekti nëpërmjet kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim duket të ketë favorizuar të pandehurin dhe kjo kërkesë e subjektit së bashku me rrethanat e konstatuara në çështjen penale në ngarkim të tij mund të çojnë në cenimin e besimit të publikut tek organet e drejtësisë, vlerësoj se subjekti nuk ka paraqitur shpjegime të mjaftueshme që përmbysin rezultatin e hetimit, për këto arsye:*

14.1 Neni 59⁸ i Kodit Penal i jep të drejtën gjykatës që, në raste të veçanta, kur jep dënimin me burgim gjer në 5 vjet, të urdhërojë që i dënuari të vihet në provë duke u pezulluar ekzekutimi i dënimit, por, në çdo rast, gjykata duhet të ketë parasysh rrezikshmërinë e pakët të personit dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale. Sikurse konstatohet në aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal, lloji i veprës penale ka rëndësi, por kushtet kryesore për aplikimin e kësaj dispozite lidhen kryesisht me të pandehurit dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale⁹.

14.2 *Për sa i përket pretendimit të subjektit se në diskutimin përfundimtar ka pasur parasysh edhe rrethanat e kryerjes së veprës penale dhe këto rrethana i ka vlerësuar në kuadrin e formës së fajit që ka qenë nga pakujdesia, nga shqyrtimi i dokumentit “Diskutim përfundimtar”, ndërmjet të tjerave, konstatohet se subjekti pasi ka parashtruar në mënyrë kronologjike veprimet hetimore arrin në konkluzionin se i pandehuri ka konsumuar elementet e veprës penale të parashikuar nga neni 290/3 i Kodit Penal, vijon me arsyetimin se pavarësisht se i ka shkaktuar vdekjen viktimës, nuk e ka dëshiruar pasojën, e më pas në lidhje me masën e dënimit ka kërkuar nga gjykata “Të marrë parasysh rrezikshmërinë mesatare të veprës penale”, rrethanë e cila nuk është vlerësuar si e tillë nga gjykata e rrethit, e cila ka vlerësuar se vepra penale është mbi mesatare, duke pasur parasysh mënyrën dhe mjetin që ka përdorur i pandehuri për kryerjen e tyre, si dhe pasojën konkrete që ka ardhur, vlerësim i cili është gjendur i drejtë edhe nga Gjykata e Apelit.*

14.3 Sa më lart, vërtetohet se subjekti ka kërkuar pezullimin e ekzekutimit të vendimit duke u bazuar vetëm në rrethanat që lidhen kryesisht me të pandehurin, duke mos vlerësuar: (i) shkallën e pakujdesisë së autorit të veprës penale, nga ku rezulton se aksidenti ka ardhur për shkak se drejtuesi i mjetit ka lëvizur me shpejtësi 161.6 km/orë, nga 80 km/orë që ka qenë

⁸ Neni 59: “Për shkak të rrezikshmërisë së paktë të personit, moshës, kushteve shëndetësore apo mendore, mënyrës së jetesës dhe të nevojave, veçanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, rrethanave të kryerjes së veprës penale, si dhe të sjelljes pas kryerjes së veprës penale, gjykata, kur jep dënim me burg deri në pesë vjet, mund të urdhërojë që i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të vihet në provë, duke pezulluar ekzekutimin e dënimit, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë vepër tjetër penale”.

⁹ Vendim nr. ***, datë 12.5.2010, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

shpejtësia e lejuar në atë segment rrugor; dhe (ii) pasojën shoqërisht të rrezikshme, vdekjen e shtetasit P. B.. Rrethana që ngrenë dyshime se subjekti me paraqitjen përpara gjykatës të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të dënimit ka pasur si qëllim favorizimin e të pandehurit.

14.4 Në përfundim, vlerësoj se subjekti ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në aftësinë e prokurorit për të interpretuar ligjin, kriter i parashikuar në pikën 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.

15. Lidhur me procedimin penal nr. * të vitit 2014**, të regjistruar për veprat penale “Vrasje me paramendim”, “Prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, të parashikuara nga nenet 78/1 e 278/4 të Kodit Penal, për të cilin Komisioni i kërkoj shpjegime subjektit të rivlerësimit për konstatimin se: *Subjekti ka marrë vendimin e datës 21.7.2015 për pezullimin e procedimit penal nr. ***/2015 jo sipas parashikimeve të nenit 326 të Kodit të Procedurës Penale, pasi: (i) nuk ka administruar kopjen e përgjimeve të shtetasit A. B. nga Sektori i Përgjimeve në Prokurorinë e Përgjithshme, si dhe nuk ka kryer veprime të mëtejshme hetimore në drejtim të këtij shtetasi, në kushtet kur ka pasur indicie se ky person është paguar për kryerjen e vrasjes së shtetasit I. B. (G.), për të cilin janë ngritur dyshime se së bashku me viktimën kanë lidhje në vrasjen e një shtetasi shqiptar në Itali; (ii) nuk ka kryer veprime hetimore ndaj shtetasit I. B., për të cilin ka pasur indicie se ka pasur marrëdhënie me viktimën, marrëdhëniet ndërmjet tyre janë prishur dhe mund ta ketë vrarë; (iii) nuk ka marrë në pyetje, si dhe nuk ka kryer veprime të mëtejshme hetimore në drejtim të shtetasit L. S. në kushtet kur familjarët e viktimës kanë ngritur dyshime se ka lidhje në vrasjen e viktimës; (iv) nuk ka kryer hetime ndaj shtetasve L. M. dhe A. M. në kushtet kur nga hetimet ka rezultuar se këtë shtetas i kanë pasur para borxh viktimës, vlerësoj se subjekti nuk ka paraqitur shpjegime të mjaftueshme që përmbysin rezultatin e hetimit, për këto arsye:*

15.1 Kodi i Procedurës Penale, në nenin 24¹⁰ parashikon se prokurori ushtron ndjekjen penale, bën hetime, kontrollon hetimet paraprake. Në vijim, në nenin 277¹¹ parashikohet se prokurori dhe policia gjyqësore zhvillojnë, brenda kompetencave të caktuara, hetimet e nevojshme që lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale. Prokurori drejton hetimet dhe ka në dispozicion policinë gjyqësore, por ai mund t'i kryejë vetë veprimet hetimore që i çmon të nevojshme (neni 304)¹². Ndërsa në nenin 326¹³ parashikon se pezullimi i hetimeve vendoset pasi të jenë kryer të gjitha veprimet e mundshme hetimore.

15.2 Në rastin konkret ka rezultuar si vijon: Së pari, familjarët e një shtetasi shqiptar të vrarë në Itali kanë ngritur dyshime se viktimë ka qenë bashkëpunëtor në vrasjen e të afërmit të tyre. Gjithashtu ka rezultuar se familjarët e viktimës të vrarë në Itali kanë paguar një shtetas për të kryer vrasjen e një personi (i identifikuar nga policia gjyqësore), që sipas tyre ka vrarë të afërmin e tyre, por vrasja e porositur nuk ka ndodhur. Më tej, shërbimet e policisë gjyqësore kanë identifikuar emrin e personit të paguar për kryerjen e vrasjes dhe është vijuar me përgjimin e numrit të tij telefonik. Në vendimin për pezullimin e procedimit penal pasqyrohet se CD-ja

¹⁰ Kodi i Procedurës Penale, neni 24: “Prokurori ushtron ndjekjen penale, bën hetime, kontrollon hetimet paraprake... në përputhje me rregullat e caktuara në këtë Kod”.

¹¹ Neni 277: “1. Prokurori dhe policia gjyqësore zhvillojnë, brenda kompetencave të caktuara, hetimet e nevojshme që lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale. 2. Prokurori drejton hetimet dhe ka në dispozicion policinë gjyqësore”.

¹² Vendim nr. 14, datë 21.7.2008, i Gjykatës Kushtetuese.

¹³ Kodi i Procedurës Penale, neni 326: “1. Kur nuk njihet autori i veprës penale ose kur i pandehuri vuan nga një sëmundje e rëndë që ndalon hetimin e mëtejshëm, prokurori vendos pezullimin e hetimeve. 2. **Pezullimi i hetimeve vendoset pasi të jenë kryer të gjitha veprimet e mundshme...**”.

që i përket këtij shtetasi nuk hapej. Nga materialet e dosjes penale të përcjella nuk rezulton të jetë kërkuar kopje tjetër CD-je nga Sektori i Përgjimeve në Prokurorinë e Përgjithshme, si dhe nuk pasqyrohen rezultatet e përgjimeve të këtij shtetasi. Gjithashtu, rezulton se nuk janë kryer veprime të mëtejshme hetimore në drejtim të tij. *Së dyti*, nga transkriptimi i përgjimeve telefonike të njërit prej familjarëve të shtetasit të vrarë në Itali ka rezultuar se gjatë bisedimeve të përqendruara rreth personit me emrin “Gofi”, ka deklaruar se ata mund të jenë zemëruar me njëri-tjetrin (me viktimën B. Rr.) dhe prandaj e kanë vrarë. Nga shqyrtimi i dosjes penale nuk rezulton të jenë kryer veprime hetimore ndaj shtetasit për të cilin ka pasur *indicie* për vrasjen e viktimës. *Së treti*, nga hetimet ka rezultuar se viktimë ka pasur mosmarrëveshje me shtetasin L. S. dhe familjarët e tij janë akuzuar nga vjehri i viktimës se i kanë bërë gjëmën, duke i lënë fëmijët jetim. Sipas informacionit të administruar nga sistem TIMS, ka rezultuar se në kohën kur ka ndodhur vrasja, shtetasi L. S. ka qenë në territorin shqiptar. Mbetet i paqartë fakti që ky shtetas nuk është marrë në pyetje, si dhe nuk janë kryer veprime të mëtejshme hetimore në drejtim të tij. *Së fundi*, nga hetimet ka rezultuar se shtetasit L. M. dhe A. M. i kanë pasur para borxh viktimës. Nuk rezulton që të jenë kryer hetime në drejtim ndaj këtyre shtetasve.

15.3 *Lidhur me shpjegimin e subjektit se nuk ka kryer veprimet hetimore ndaj shtetasve të cituar më sipër, të dyshuar si autor apo bashkautor në kryerjen e veprës penale të vrasjes së shtetasit B. Rr. (N. M.), pasi nuk janë gjetur dyshime se janë larguar jashtë territorit të Shqipërisë në mënyrë të jashtëligjshme, vlerësoj se ky shpjegim është jo vetëm që nuk është bindës, por tregon edhe mangësi të theksuara të subjektit në drejtim të ndjekjes logjike të hetimit, për sa kohë që nga hetimet ka pasur *indicie* dhe janë ngritur dyshime të arsyeshme se shtetasit e mësipërm mund të jenë autorë të veprës penale.*

15.4 *Lidhur me pretendimin e subjektit se Komisioni nuk ka kompetencë për të marrë në shqyrtim këtë çështje, Kolegji ka një jurisprudencë të gjerë¹⁴, duke u shprehur se: “Kolegji ka pranuar se zbatimi i nenit E, paragrafi i 2-të i Aneksit të Kushtetutës, i cili parashikon se: [...] Vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim, do të zbatohet ndaj atyre çështjeve të cilat janë në shqyrtim në kohën e kryerjes së procesit të rivlerësimit prej vetë magjistratit që po i nënshtrohet procesit të rivlerësimit dhe jo nga organe të tjera më të larta apo alternative, siç është rasti në fjalë”. Për pasojë, vlerësoj se Komisioni nuk ndodhet në kushtet e pengesës ligjore të parashikuar nga neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës dhe legjitimohet të analizojë e vlerësojë këtë çështje në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.*

15.5 Në përfundim, vlerësoj se subjekti ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, duke u bazuar në aftësinë e prokurorit për të hetuar dhe për të marrë urdhra dhe vendime, në aftësinë e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, kritere që parashikohen në pikën 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.

16. Lidhur me kallëzimin penal nr. * të vitit 2015**, të shtetasit A. A., i cili ka kallëzuar faktin e shkatërrimit të pronës së tij në fshatin ***, Fier, për të cilin Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit për konstatimin se: *(i) Subjekti duket se ka marrë vendimin e datës 18.6.2015 për mosfillimin e kallëzimit penal pa u plotësuar kushtet e parashikuara nga neni 290 i Kodit të Procedurës Penale, pasi nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore për verifikimin e pretendimeve të kallëzuesit, si më poshtë vijon: këqyrjen në vend të banesës së*

¹⁴ Shihni vendimet e Kolegjit nr. 7/2019 (JR); nr. 16/2020 (JR); nr. 28/2020; (JR) nr. 25/2023.

pretenduar nga kallëzuesi si e shkatërruar; kryerjen e ekspertimit për përcaktimin nëse banesa e pretenduar nga kallëzuesi është në pronësi të tij dhe nëse kjo banesë ishte shkatërruar si pasojë e amortizimit apo ka pasur ndërhyrje për prishjen e saj; (ii) Duket se konkluzioni i subjektit në vendimin e datës 18.6.2015 për mosfillimin e kallëzimit penal, nuk mbështetet në faktet dhe provat e administruara, nga ku rezulton se kallëzuesi ka paraqitur AMTP-në dhe listën emërore të pronarëve të trojeve dhe shtëpive të fshatit *** dhe se nuk është provuar në dokumentet e paraqitura pronësia mbi banesën e vjetër objekt kallëzimi; (iii) Duket se përfundimi i subjektit në vendimin e datës 18.6.2015 për mosfillimin e kallëzimit se “banesa e kallëzuesit ka qenë e vjetër dhe e amortizuar dhe, për rrjedhojë, nuk kemi shkatërrim të pronës me dashje” nuk është i bazuar në ndonjë akt të përgatitur nga ekspertë të fushës, me njohuri të posaçme në fushën e ndërtimit; (iv) Duket se në vendimin e datës 18.6.2015 për mosfillimin e procedimit penal, subjekti nuk ka analizuar elementet e figurës së veprës penale të “Vetëgjyqësisë”, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal, në raport me faktet dhe rrethanat e çështjes, në kushtet kur: ndërmjet kallëzuesit dhe të kallëzuarit po zhvillohej një proces gjyqësor civil lidhur me pretendimet e tyre të pronësisë për banesën dhe truallin objekt kallëzimi penal; kallëzuesi ka paraqitur dokumentacionin që vërteton të drejtën e pronësisë së banesës (sipas arsyetimit të mësipërm); sipas aktit të ekspertimit të procesit civil të paraqitur nga kallëzuesi banesa e vjetër e pretenduar nga ana e tij ndodhet në kushtet e themeleve (e shkatërruar) dhe pronën e pretenduar nga kallëzuesi e shfrytëzon të gjithën i kallëzuari, vlerësoj se subjekti nuk ka paraqitur shpjegime të mjaftueshme që përmbysin rezultatin e hetimit, për këto arsye:

16.1 Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë¹⁵ në jurisprudencën e tyre kanë arsyetuar se rastet e mosfillimit të çështjes penale nuk kërkojnë ndonjë hetim të thellë. Konstatimi i rrethanave është i lehtë dhe përgjithësisht bëhet para fillimit të procedimit penal, për këtë mjaftojnë vetëm disa verifikime të shpejta për të konkluduar rreth marrjes së një vendimi mosfillimi.

16.2 Në dispozitivin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal subjekti ka vendosur mosfillimin e kallëzimit penal për veprat penale “Shkatërrimi i pronës” dhe “Vetëgjyqësia”. Nga analizimi i dispozitave ligjore për secilën veprë penale në raport me faktet, rezulton si vijon: Lidhur me veprën penale “Shkatërrimi i pronës”, të parashikuar nga neni 150¹⁶ i Kodit Penal, rezulton se shërbimet e policisë gjyqësore nuk kanë bërë këqyrjen në vend për të evidentuar shkatërrimin e banesës së pretenduar nga kallëzuesi, por kanë administruar vetëm dokumentet e paraqitura nga kallëzuesi, konkretisht: AMT-në, listën emërore të pronarëve të trojeve dhe shtëpive të fshatit ***, si dhe aktin e ekspertimit të dorëzuar në procesin gjyqësor civil, ku pasqyrohet se prona e kallëzuesit ishte në themele¹⁷. Në këto kushte, në vijim të ndjekjes logjike të hetimit, ishte e nevojshme këqyrja në vend e banesës së kallëzuesit, si dhe kryerja e ekspertimit për përcaktimin nëse banesa ishte shkatërruar me kalimin e kohës apo ka pasur ndërhyrje për prishjen e saj.

16.3 Më tej, subjekti vendimin për mosfillimin e procedimit penal, ndërmjet të tjerave, e mbështet në arsyetimin se kallëzuesi nuk ka paraqitur dokumentacionin e pronësisë mbi

¹⁵ Vendimi unifikues nr. 2, datë 20.6.2013.

¹⁶ “Shkatërrimi apo dëmtimi me dashje i pronës, kur pasojat materiale nuk janë të lehta, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet”.

¹⁷ Në aktin e ekspertimit, eksperti ka konstatuar se: “Kemi të bëjmë me dy prona në pronësi të dy pronarëve, që janë A. A. dhe B. A., se kemi të bëjmë me dy prona të ndodhura në të njëjtën ngastër që ka nr. *** dhe të dy këta pronarë kanë sipërfaqe të njëjta prona (420 m²+420 m²)”. Më pas, eksperti konstaton se banesa që ndodhet në pronën që përkon me nr. pasurie 69/18 e pretenduar nga kallëzuesi (A. A.) është “banesë në themele” dhe se pronën me nr. pasurie *** e shfrytëzon të gjithën i kallëzuari.

banesën e vjetër objekt kallëzimi, si një nga elementet e domosdoshme të figurës së veprës penale “Shkatërrimi i pronës” apo “Vetëgjyqësia”. Për sa i përket këtij arsytimi, vlerësoj se objekti i veprës penale të parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal janë marrëdhëniet juridike të vendosura nga shteti për të siguruar paprekshmërinë e pronësisë mbi sendet, ku në të drejtat e pronësisë sipas Kodit Civil janë disponimi, gëzimi dhe përdorimi. Kjo dispozitë nuk mbron vetëm pronat e subjekteve të cilat janë regjistruar në regjistrat publikë, por edhe pronat për të cilat ato kanë dokumente që vërtetojnë gëzimin apo përdorimin e tyre. Në rastin konkret rezulton se kallëzuesi për vërtetimin e pronësisë ka paraqitur AMTP-të ku pasqyrohet sipërfaqja e truallit, si dhe listën emërore të pronarëve të trojeve dhe shtëpive të fshatit ***. Duke marrë në konsideratë faktin që trojet dhe shtëpitë në zonat urbane të fshatrave regjistroheshin sipas listës emërore¹⁸ dhe banesa e kallëzuesit figuron në listën emërore të fshatit ***, është vërtetuar se kallëzuesi ka paraqitur dokumentacionin e nevojshëm që provon pronësinë (gëzimin, përdorimin) e tij mbi banesën e pretenduar.

16.4 Lidhur me veprën penale “Vetëgjyqësia”, të parashikuar nga neni 277¹⁹ i Kodit Penal, vlerësoj se në kuptim të kësaj dispozite, autori i veprës penale vepron duke shkelur dhe “zëvendësuar” veprimin e organit kompetent i cili, nga ana e tij, ka juridiksionin, kompetencën dhe detyrën që të zgjidhë konfliktin mes palëve sipas ligjit, me objektivitet dhe paanshmëri. Ky veprim i autorit, në vetvete është i paligjshëm dhe arbitrar. Nga pikëpamja e anës objektive, vetëgjyqësia kryhet nga autori nëpërmjet ushtrimit arbitrar të së drejtës, me forma të ndryshme të dhunës fizike a psikike (kanosjes etj.), drejtpërdrejt mbi personin ose indirekt, duke vepruar mbi sendin a interesin mbi të cilin ekziston apo pretendohet se ekziston e drejta (e ligjshme) e autorit të veprës²⁰.

16.5 Në rastin konkret rezulton se: (i) ndërmjet kallëzuesit dhe të kallëzuarit po zhvillohej një proces gjyqësor civil lidhur me pretendimet e tyre të pronësisë për banesën dhe truallin objekt kallëzimi penal; (ii) kallëzuesi ka paraqitur dokumentacionin që vërteton të drejtën e pronësisë së banesës (sipas arsytimit të mësipërm); (iii) sipas aktit të ekspertimit të procesit civil të paraqitur nga kallëzuesi, banesa e vjetër e pretenduar nga ana e tij ndodhet në kushtet e themeleve (e shkatërruar) dhe pronën e pretenduar nga kallëzuesi e shfrytëzon të gjithën i kallëzuarit. Sa më lart, rezulton se subjekti në vendimin e datës 18.6.2015 ka arritur në përfundimin për mosfillimin e kallëzimit penal për veprën penale “Vetëgjyqësia” të parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal, pa analizuar elementet e figurës së veprës penale në raport me faktet dhe rrethanat e çështjes.

16.6 Për sa i përket shpjegimit se ka vendosur mosfillimin për shkak se mosmarrëveshja ishte duke u shqyrtuar nga gjykata civile, vlerësoj se ky shpjegim nuk mbështetet në parashikimet e Kodit të Procedurës Penale dhe në natyrën dhe qëllimet që ndjek procesi penal i cili, në dallim nga procesi civil, që ka karakter objektiv, ka karakter subjektiv, ku qëllimi kryesor është identifikimi i autorit të veprës penale, me qëllim vënien e tij para përgjegjësisë penale.

16.7 Në përfundim, vlerësoj se subjekti ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, duke u bazuar në aftësinë e prokurorit për të për të hetuar dhe për të marrë urdhra dhe vendime, në aftësinë e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe aspektin e arsytimit ligjor

¹⁸ VKM nr. 432, datë 14.8.1995 “Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonën urbane të fshatit”.

¹⁹ Kodi Penal, neni 277: “Ushtrimi i një të drejte prej personit që i përket ose që kujton se i përket dhe që nuk njihet nga tjetri pa iu drejtuar organit kompetent shtetëror, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre muaj”.

²⁰ Vendim nr. 1, datë 25.3.2005, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

bazuar në treguesin e cilësisë së analizës, kritere të parashikuara nga pikat 2 dhe 3 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.

Denoncime nga publiku

17. Në lidhje me denoncimin nr. * prot., datë 28.10.2019**, të shtetases M. B., për të cilën Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit shpjegime për konstatimin se: *Subjekti ka marrë vendimin e datës 30.5.2019 për mosfillimin e procedimit penal ndaj shtetases B. S., pa vlerësuar faktin se ndërmjet kallëzueses dhe të kallëzuarës B. S. ekzistonte lidhja familjare në formën e krushqisë së afërt*, vlerësoj se subjekti nuk ka paraqitur shpjegime të mjaftueshme që përmbysin rezultatin e hetimit, për këto arsye:

17.1 Në përgjigje të rezultateve të hetimit²¹, subjekti shpjegon se në rastin konkret është zbatuar ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhënie familjare”, i ndryshuar²². Duke patur parasysh formulimin e ligjit të mësipërm, në rastin konkret raportet midis M. B., D. E. dhe vajzës së kësaj të fundit B. S., nuk është krushqi e afërt pasi as B. S. nuk konsiderohet thjesht e shtetases M. B. dhe as kjo e fundit nuk konsiderohet njerka e B. S.. Shtetasi Rr. L. nuk ka lidhje martesore me shtetasen M. B., por kanë qenë thjesht në raporte bashkëjetuese. Në vijim shpjegon se palët në konflikt D. E. dhe vajza e saj B. S. nga njëra anë dhe M. B. nga ana tjetër nuk jetonin në të njëjtën banesë.

17.2 Shpjegimi i mësipërm i subjektit nuk mbështet në situatën faktike dhe ligjore, pasi nga shqyrtimi i dosjes së kallëzimit penal nr. *** konstatohet se shtetasja M. B. në kallëzimin e saj ka deklaruar se është martuar me shtetasin Rr. L.. Nuk rezulton që subjekti të ketë administruar certifikatën e përbërjes familjare të kallëzues me qëllim sqarimin e pretendimeve të saj se është e martuar, rrethanë kjo që do të shërbente në kualifikimin e saktë ligjor të veprës penale. Në vijim, në vendimin nr. ***, datë 3.12.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me të cilën është gjykuar ankimi i shtetases M. B. ndaj vendimit të datës 25.10.2019 të subjektit të rivlerësimit, konstatohet se në pjesën ku pasqyrohen palët ndërgjyqëse, ankuesja identifikohet me gjendjen civile “e martuar”. Sa më lart, pretendimi i subjektit se shtetasi Rr. L. nuk ka lidhje martesore me shtetasen M. B., por kanë qenë thjesht në raporte bashkëjetuese, nuk bazohet në dokumentacionin e administruar në kuadër të kallëzimit penal dhe subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion përkatës që vërteton shpjegimit e tij.

17.3 Megjithatë, neni 3²³, pika 7 e ligjit nr. 9669/2006, i ndryshuar me ligjin nr. 47/2018²⁴, parashikon se pjesëtarë të familjes janë edhe fëmijët e partnerëve bashkëjetues, e për pasojë kallëzuesja gëzonte mbrojtje ligjore ndaj dhunës së vajzës së bashkëjetuesit sipas nenit 130/a të Kodit Penal.

17.4 Në përfundim, vlerësoj se subjekti ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, duke u bazuar në aftësinë e prokurorit për të interpretuar ligjin, kriter që parashikohet në pikën 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.

18. Në lidhje me denoncimin nr. * prot., datë 15.1.2020**, të shtetasit E. H., për të cilin Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit shpjegime për konstatimin se: *(i) Duket se konkluzioni i subjektit në vendimin e datës 3.2.2020 për njoftimin e akuzës të pandehurit dhe*

²¹ Email datë 4.6.2024

²² Me ligjet nr. 9914, datë 12.5.2008, nr. 10329, datë 30.9.2010, nr. 47/2018, datë 23.7.2018.

²³ Neni 3, pika 7: “7. Pjesëtarë të familjes” janë: ...ç) prindërit e bashkëshortit/es ose të bashkëjetuesit/es, përfshirë dhe thjeshtin/thjeshtren, edhe sikur kjo lidhje të burojë nga birësimi; ...e) fëmijët e bashkëshortëve ose partnerëve bashkëjetues...”.

²⁴ Botuar në Fletore Zyrtare nr. 115, datë 3.8.2018.

në kërkesën e datës 13.2.2020 për pushimin e ndjekjes penale, nuk gjen zbatim në parashikimet e neneve 283, 22 të Kodit Penal; (ii) Duket se konkluzioni i subjektit se masa e sigurimit nuk i përgjigjet rëndësisë së faktit pa marrë në konsideratë konsumimin e elementeve të figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, e mbetur në tentativë, nuk është i bazuar ne provat e administruara, vlerësoj se subjekti ka paraqitur shpjegime të mjaftueshme që përmbysin pjesërisht rezultatin e hetimit, si vijon:

18.1 Në përgjigje të rezultateve të hetimit²⁵, subjekti shpjegon se objekt i aktit të ekspertimit kimik me nr. ***, datë 1.10.2019, kanë qenë 28 bimët që janë gjetur në afërsi të vreshtave të të pandehurit S. S. dhe jo lënda bimore e thatë apo farërat ku këto të fundit janë gjetur në banesë. Në lidhje me farat, të dyshuara të llojit *canabis sativa* të sekuestruara gjatë kontrollit të banesës me peshë 48.20 gr., shpjegon subjekti, OPGJ-ja ka marrë vendimin e datës 26.8.2019 për të kryer ekspertimin kimik, por ka qenë një lapsus pasi me shkresën përcjellëse Drejtoria e Policisë Vendore Fier i ka dërguar Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë Krujë vendimin e datës 10.9.2019 për kryerjen e ekspertimit teknologjik-bujqësor të farave. **Më tej, thekson se për farërat nuk është kryer akt ekspertimi kimik, por vetëm është urdhëruar mbjellja e tyre.**

18.2 Nga shqyrtimi i dosjes penale rezulton pretendimi i subjektit që farërat nuk i janë nënshtruar aktit të ekspertimit kimik, është i drejtë, pasi farërat e gjendura në banesën e të dyshuarit janë sekuestruar dhe janë mbyllur në qesen me nr. unik *** dhe këto farëra i janë nënshtruar vetëm ekspertimit teknologjik bujqësor, ku ka rezultuar se nuk kanë aftësi prodhuese (mbirje). Megjithatë konstatohet se oficeri i policisë gjyqësore me vendimin e datës 26.8.2019 ka vendosur kryerjen e aktit të ekspertimit kimik të lëndës së dyshuar si narkotike, mbyllur në qesen me nr. unik ***, duke shtruar edhe pyetjen përkatëse për ekspertin nëse farërat e sekuestruara janë të bimëve narkotike. Nuk rezulton që subjekti të ketë vendosur anulimin e aktit të ekspertimit për shkak lajthimi i të OPGJ-së, sikurse shpjegon në përgjigje të rezultateve të hetimit. Sa më sipër, vlerësoj se administrimi i aktit të ekspertimit kimik të farërave të sekuestruara, ishte i rëndësishëm për çështjen pasi rezultati i këtij akti mund të ndikonte në cilësimin ligjor të veprës penale në rast se farërat do të rezultonin si produkte të ndonjë bime narkotike.

18.3 Në përfundim, vlerësoj se subjekti ka treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, kriter që parashikohet në pikën 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.

Konstatime të tjera

19. Lidhur me procedimin penal nr. * të vitit 2019**, për të cilin Komisioni u njoh nëpërmjet mediave televizive²⁶, i kërkoi subjektit të rivlerësimi shpjegime, për konstatimin se: (i) *Subjekti në vendimin për marrje si të pandehur të shtetasit F. A. dhe në kërkesën për dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. *** të vitit 2019, nuk ka analizuar faktin nëse paraqitja e rreme e atësisë dhe amësinë nga i pandehuri në dokumentet noteriale ka cenuar pjesën përshkruese-dëftuese të dokumenteve ku pasqyrohen të drejtat dhe detyrimet e palëve;* (ii) *Interpretimi i subjektit në dokumentin “Konkluzione përfundimtare” se “i pandehuri ka fshehur me qëllim dhe me dashje faktin se nuk ishte më djali ligjor i shtetasve Z. dhe B. A., pasi nuk mund të pretendonte dhe të merrte dëmshpërblimin nga vdekja e vëllait të tij*

²⁵ Email datë 4.6.2024.

²⁶ <https://stop.tvklan.al/15-vjecari-u-vra-gabimisht-nga-italiani-prokurori-spyet-per-tragjedi-kerkon-20-e-demshperblimit/>

biologjik, për shkak se ishte i birësuar në një familje tjetër” nuk mbështetet në jurisprudencën unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të cilët kanë konkluduar se kërkesa për dëmshpërblim nga fakti i paligjshëm nuk kushtëzohet me gëzimin e cilësisë së trashëgimitarit të një personi të dëmtuar, por vetëm me cilësinë e vete paditësit si i dëmtuar nga fakti i paligjshëm.

20. Në përgjigje të rezultateve të hetimit²⁷, subjekti shpjegon se me ligjin shqiptar i birësuar nuk trashëgon nga familja e origjinës, por në rastin konkret rëndësi merrte fakti se çfarë parashikonte legjislacioni italian për rastin konkret, pasi gjykimi civil për shpërblimin e dëmit është kryer në Itali. Fakti që i pandehuri në hetim në Itali ka përdorur si amësi dhe atësi ato të prindërve biologjikë, vijon subjekti, tregon se edhe sipas ligjit italian ai nuk mund të përfitonte dëmshpërblimin përkatës. Më tej, shprehet se përdorimi nga i pandehuri i të dhënave jo të vërteta për sa i përket amësisë dhe atësisë të ndryshme nga ato që ka pasur në zyrën e gjendjes civile të Republikës së Shqipërisë, kanë pasur si qëllim ardhjen e pasojës së kundërligjshme të përfitimit të padrejtë të dëmshpërblimit. Gjithashtu, shpjegon se ka mendimin se përderisa çështja nuk është zgjidhur përfundimisht me një vendim të formës së prerë pasi ndodhet për shqyrtim Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Komisioni nuk ka kompetencë për ta marrë në shqyrtim këtë çështje, pasi këtë e ndalon paragrafi i parë i nenit 43 i ligjit nr. 84/2016, si dhe pika 4 e nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.

21. Në rastin konkret rezulton se në kërkesën për dërgimin e çështjes për gjykim subjekti, ndërmjet të tjerave, ka arsyetuar se shtetasi F. A. ka konsumuar elementet e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal, pasi ka dhënë dhe ka përdorur përpara noterit publik, organeve shtetërore shqiptare dhe gjykatave italiane, dokumente me përmbajtje tërësisht të falsifikuara në përmbajtjen e tyre sikur është djali ligjor i shtetasve L. dhe N. A., kur në fakt është birësuar nga shtetas të tjerë dhe ka gjeneralitete të tjera në emrin e të atit dhe nënës së tij dhe ka vendlindje tjetër nga ajo që ka deklaruar. Sipas subjektit, vepra penale është kryer në mënyrë të vazhdueshme dhe më shumë se një herë, duke qenë në krim vazhdues. Më tej, në dokumentin “Konkluzione përfundimtare” arsyetohet se: “...ky shtetas në të gjitha dokumentet e paraqitura dhe të nënshkruara prej tij ka fshehur me qëllim dhe me dashje faktin se nuk ishte më djali ligjor i shtetasve Z. dhe B. A.... dhe rrjedhimisht nuk mund të pretendonte dhe të merrte ndonjë të drejtë dëmshpërblimi duke u bazuar në parashikimet ligjore të nenit 362/2 të Kodit Civil... si dhe të nenit 259 të Kodit të Familjes...”. Më tej, arsyetohet se në dokumentet noteriale i pandehuri ka materializuar pasqyrimin e një rrethane të rreme, në formën e falsifikimit intelektual, e cila ka dhënë efekt juridik pasi ka shërbyer si kusht për paraqitjen e kërkesës dhe rrjedhimisht për përfitimin e dëmshpërblimit në gjykatën italiane.

22. Për sa i përket pretendimit të subjektit që sipas ligjit shqiptar i birësuar nuk trashëgon nga familja e origjinës, vlerësoj se ky shpjegim i subjektit është irrelevant, pasi në rastin konkret i pandehuri ka kërkuar shpërblimin e dëmit moral, ekzistencial që ka pësuar nga vdekja e vëllait të tij biologjik. Gjithashtu, ky pretendim nuk mbështetet në jurisprudencën unifikuese të Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë²⁸, të cilët kanë arritur në përfundimin se: “Çdo subjekt i cenuar në të drejta dhe interesa të ligjshme personale e pasurore nga fakti i paligjshëm, edhe nëse nuk është ai vetë subjekti pasiv i atij fakti, ka të drejtën subjektive, legjitimimin aktiv, për kërkuar (ius proprius) dëmshpërblimin e dëmit pasuror e jopasuror të

²⁷ Email datë 4.6.2024.

²⁸ Vendimin nr. 12, datë 14.9.2007.

pësuar. Ky legjitimim aktiv, në parim, nuk kushtëzohet me gëzimin e cilësisë së trashëgimitarit të një personi të dëmtuar, por vetëm me cilësinë e vete paditësit si i dëmtuar nga fakti i paligjshëm...”.

23. Për sa i përket shpjegimit të subjektit se në rastin konkret rëndësi merrte fakti se çfarë parashikonte legjislacioni italian për rastin konkret, pasi gjykimi civil për shpërblimin e dëmit është kryer në Itali dhe përdorimi nga i pandehuri i të dhënave jo të vërteta për sa i përket amësisë dhe atësisë të ndryshme nga ato që ka pasur në zyrën e gjendjes civile të Republikës së Shqipërisë, kanë pasur si qëllim ardhjen e pasojës së kundërligjshme të përfitimit të padrejtë të dëmshpërblimit, vlerësoj se ky shpjegim nuk mbështetet në legjislacionin shqiptar, pasi neni 6 i Kodit Penal parashikon se: “Ligji penal i Republikës së Shqipërisë është i zbatueshëm edhe për shtetasin shqiptar që kryen krim në territorin e një shteti tjetër, kur krimi është njëkohësisht i dënueshëm dhe derisa nuk është dhënë për të një vendim përfundimtar nga një gjykatë e huaj”. Sikurse konstatohet, ligji penal shqiptar zbatohet në ato raste kur vepra është njëkohësisht e dënueshme si nga legjislacioni shqiptar, ashtu edhe nga ai i huaj. Nga analizimi i rezultateve të hetimit është konstatuar se sipas legjislacionin shqiptar fakti nuk përbënte vepër penale. Për pasojë, edhe sikur të parashikohet nga ligji italian rasti konkret si vepër penale, subjekti nuk mund të ushtronte ndjekjen penale për sa kohë që nuk parashikohet si e tillë nga ligji shqiptar.

24. Lidhur me pretendimin e subjektit se për sa kohë çështja është për shqyrtim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Komisioni nuk ka kompetencë për të marrë në shqyrtim këtë çështje, theksoj edhe një herë se Kolegji ka një jurisprudencë të gjerë²⁹, në raste të ngjashme, duke u shprehur se: “Kolegji ka pranuar se zbatimi i nenit E, paragrafi i 2-të i Aneksit të Kushtetutës, i cili parashikon se: [...] Vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim, do të zbatohet ndaj atyre çështjeve të cilat janë në shqyrtim në kohën e kryerjes së procesit të rivlerësimit prej vetë magjistratit që po i nënshtrohet procesit të rivlerësimit dhe jo nga organe të tjera më të larta apo alternative, siç është rasti në fjalë”. Për pasojë, Komisioni nuk ka qenë në kushtet e pengesës ligjore të parashikuar nga neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës dhe ishte i legjitimuar të analizonte e vlerësonte edhe këtë çështje në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

25. Në përfundim, vlerësoj se në rastin konkret subjekti ka treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore, duke u bazuar në aftësinë e prokurorit për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën, kritere që parashikohen në pikën 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.

26. Megjithatë, edhe për sa i përket kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, vlerësoj se mangësitë e konstatuara nuk janë të mjaftueshme për të arritur në konkluzionin se subjekti rezulton i papërshtatshëm nga vlerësimi i aftësive profesionale dhe nuk janë të mjaftueshme për vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit në raport me kontrollin e kriterit profesional. Por, çmoj se problemet e konstatuara në vlerësimin profesional duhet të merren në konsideratë në një vlerësim të përgjithshëm për të tria kriteret e procesit të rivlerësimit që është kryer ndaj subjektit.

27. Në përfundim, unë, si anëtare/relatore e trupit gjykues, në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në vlerësim të përgjithshëm për të tria kriteret e rivlerësimit për subjektin, bazuar në konkluzionet e mësipërme, çmoj se shkeljet dhe problematikat e konstatuara në drejtim të secilit prej kriterëve, të vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës, si dhe mangësive që

²⁹ Shihni vendimet e Kolegjit nr. 7/2019 (JR); nr. 16/2020 (JR); nr. 28/2020 (JR); nr. 25/2023.

rezultuan në kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, së bashku me mangësitë e konstatuara prej vlerësimit të denoncimeve nga publiku, më çojnë në përfundimin se subjekti i rivlerësimit e ka cenuar me veprimet dhe sjelljen e tij profesionale, por edhe për sa i përket kriterit të vlerësimit të pasurisë, besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

28. Si konkluzion, në vlerësimin tërësor të subjektit të rivlerësimit, unë si anëtare/relatore në pakicë, vlerësoj se problematikat e konstatuara në drejtim të kontrollit të pasurisë, kontrollit të figurës apo aftësive profesionale, nuk përbëjnë shkak shkarkimi më vete por, nga ana tjetër, pesha e këtyre mangësive në vlerësimin tërësor të subjektit është e tillë që e bën të pamundur riparimin e tyre nëpërmjet programit të trajnimit të Shkollës së Magjistraturës dhe, si rrjedhojë, konkludoj se vazhdimi i ushtrimit prej tij të funksioneve të prokurorit do të ishte i papërshtatshëm dhe në kundërshtim me qëllimin dhe parashikimet e nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe, për pasojë, në zbatim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, shumica e trupit gjykues duhet të kishte vendosur shkarkimin e tij nga detyra.

**Anëtare Kundër
ETLEDA ÇIFTJA**